



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr. 4795 Prot

Gjirokastër më 04 : 06 :2024

Lënda: Procesverbal i mbledhjes së datës 31.04 .2024

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion procesverbalin e mbledhjes së datës 31.05 .2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot në 31.05 .2024 në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastër. Mbledhja po zhvillohet në sallën e Mediatekës pranë Universitetit “Eqrem Çabej”. Mbledhja fillon në orën 12:10.

Marrin pjesë në mbledhje 16 anëtarë. Mungojnë në mbledhje , Feruni, Koçollari, Rova, Kristidhi, Shehaj, Aliko, Pandos, Kore, Çuçani, Drasa, Mahmutaj, Shehaj, Novi.

Vijnë me vonesë pasi ka filluar mbledhja Qeli dhe Çabeli.

Hapet mbledhja nga Znj. Isaraj. Është kuorumi për fillimin e mbledhjes.

Znj. Isaraj paraqet rendin e ditës.

1.Miratim i procesverbalit të mbledhjes së datës 30. 04.2024.

2.P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01-31.05. 2024”.

3.P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin 01-31.05. 2024”.

4.P/ Vendim“Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Gjirokastër së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen Z.Çezar Gjoksi i cili është dëmtuar nga djegja e banesës së tij private si rezultat i rënies së zjarrit”.

5.P/Vendim për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” (pas vdekjes) për z. Roland Karalli”.

6.P/Vendim “Për miratimin e Planit të Masave për Mbrojtjen nga Zjarri për periudhën qershor-tetor 2024.

7.Raporti i punës i Drejtorisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi.

8.Trajtimi i kërkesës për shpalljen e titullit “Dëshmor i Atdheut”për z.Foto Koço Piperi.

9.Trajtimi i kërkesave të qytetarëve.

10.Të ndryshme.

Miratohet me 16 vota pro rendi I ditës së mbledhjes.

Hidhet në votë dhe miratohet me 16 vota pro procesverballi I mbledhjes së datës 30.04,2024.

Znj. Isaraj paraqet pikat 2 dhe 3 të rendit të ditës .

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01-31.05. 2024”.

3.P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin 01-31.05 2024”, të cilat miratohen me 21 vota pro.

Znj.Isaraj :hedh në votë dhe miratohet me 16 vota pro P/Vendim “ Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Gjirokastër së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen Z.Çezar Gjoksi i cili është dëmtuar nga djegja e banesës së tij private si rezultat i rënies së zjarrit “

Znj. Isaraj: Lexon pikën 5. P/Vendim për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” (pas vdekjes) për z. Roland Karalli”, i cili ka qenë pjesë e Këshillit, përveç kontributit si mjek ka dhënë edhe kontribut në drejtimin e Këshillit Bashkiak për disa vite.

Z. Hila: Prisja më shumë fjalë nga ju për kontributin e z. Roland Karalli .

ZNJ. Isaraj: Ne do jemi pjesë e ceremonisë që do të organizohet për dhënien e titullit të nderit.

Kalohet te pika 6 .P/Vendim “Për miratimin e Planit të Masave për Mbrojtjen nga Zjarri për periudhën qershor- tetor 2024.

Z. Brahimi: Materiali I qartë, jemi falënderues, të vazhdohet edhe këtë vit që të mos kemi situatë të para disa viteve .Mendoj që duhet një material I përbashkët për të dyja drejtoritë që të rakordoni me njëra tjetrën për çdo masë që do të merren kundër zjarrit.

Z. Llogo: Ne kemi bashkëpunim të mirë me DMZSH, por kemi vështirësi me zonën muzeale për shkak të terrenit dhe ndërtesave të vjetra dhe të amortizuara . Në orët e pikut do të na duhet një shërbim shtesë me njerëz.

A. Hilaj: Relacioni ishte i saktë dhe i plotë, por nëse ju duhet ndonjë ndihmë nga këshilli për mjete mbështetëse që jut ë mos keni vështirësi në punën tuaj, ne kemi kompetencë t ju mbështesim.

Z. Gramoz Lapi: Në përgjigje të Petritit ne e kemi të hartuar planin e përbashkët dhe e kemi të miratuar nga Kryetari I Bashkisë. Jemi duke punuar me njësitë administrative, me trajnimin dhe informacine ku marrin pjesë fermerët, çobanët dhe të gjithë personat e interesuarNe I kemi mjetet dhe mbështetjen e duhur të cilat ju I keni miratuar me buxhetin e vitit te kaluar, por për çdo kërkesë ne kemi përsëri mndësi m buxhetin e ardhshëm dhe do t jua paraqesim.

Hidratantët janë në punë. Kështu që I kemi marrë të gjitha masat , të cilat I keni në plan , por edhe te Raporti vjetor I punës.

Hidhet në votë dhe miratohet me 17 vota pro P/Vendim “Për miratimin e Planit të Masave për Mbrojtjen nga Zjarri për periudhën qershor- tetor 2024”

Kalohet te pika 8 e rendit të ditës: Trajtimi i kërkesës për shpalljen e titullit “Dëshmor i Atdheut”për z.Foto Koço Piperi”

Z. Brahimi: Pse vjen në Këshill kjo kërkesë, derisa Komisioni I Bashkisë e ka argumentuar përgjigjen negative?

Z. Nebiaj: Është kompetencë e këshillit, sepse Këshilli ka kompetencë për ta trajtuar .

Hidhet në votë dhe miratohet me 16 vota pro Mospranimii kërkesës për shpalljen e z. Foto Koço Piperi “ Dëshmor i Atdheut”.

Kalohet te kërkesat e qytetarëve:

Z. Brahim: Kemi ngritur disa herë çeshtjet e trafikut në qytet dhe s'kemi marrë përgjigje. Shqetësim tjetër, hapet një biznes për makina me qira dhe banorët nuk kanë ku parkojnë se parkon biznesi gjithë zonën e pallatit.

Ka 6 muaj që kërkohet një tabelë në shkollën "Naim Frashëri", kaq e vështirë ju duket për një tabelë?

Në "Urën e Lumit", pas orës 2 nuk ka fugon, nuk kanë njerëzit me çfarë të lëvizin për në njësitë administrative.

ZNJ: Isaraj :Paraqet para këshilltarëve kërkesën e znj Oriela Trako, sportiste profesioniste për "Natural bodybuilding" për mbështetje financiare për pjesëmarrje në një aktivitet sportive që do të zhvillohet në datat 13-15 qershor në Hollandë.

Z. Guçe: I propozoj këshillit të miratojmë një fond 100.000 mijë lekë për të mnështetur këtë sportiste që na nderon me talentin e saj.

Hidhet në votë propozimi z. Guçe dhe miratohet me 17 vota pro.

Për kërkesën e Shoqërisë Argjiro për monitorimin me Polici Bashkiake, SQARON Z. Nebiaj se nuk ka bazë ligjore që monitorimi i linjave të kryhet nga Policia Bashkiake, bashkia ka kompetencë vetëm shërbimin urban Brenda qytetit dhe në njësiotë.Linjat ndërqytetëse janë kompetencë e Ministrisë së Transportit dhe ata i çertifikojnë iteneraret e tyre.

Z. Qeli: si do veprohet me tabelat e qarkullimit se me investimin e Fondit të Zhvillimit është bërë më e vështirë lëvizja në laGJEN "Kodra e Shtufit". Duhet të shkosh te Ura e lumit që të kthehesh në lagje.Duhet të hapet siç ka qenë sepse sjell vështirtësi te qytetarët.Rruga bëhet për të lehtësuar trafikun.

Z. Brahim: Te investimet që po bën firma, ka qenë lulishte, pse të mos ta bëjë firma si ishte por të kthehet përsëri lulishte siç ka qenë me punëtorët e komunales?

Z. Nebiaj: Plani I mobilitetit të qytetit po financohet dhe është një investim I Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Ky është një investim 10 miliard lekë në të mirë të qytetit.

Specialistët e kanë menduar kështu.

ZNJ. Cacaj: Ndërhyrja e Petrit është e drejtë, është vërtet investim I FSHZH, por për rampat u bënë gabim dhe u rregulluan pas ankesave të znj. Vjollca Koko, sepse edhe specialistët mund të bëjnë gabime

Për kërkesën për vendosjen e emrit të "Agron Galanxhi" aeroportit të Gjirokastrës, këshilltarët u shprehën se jemi herët për trajtimin e saj dhe emri mund të vendoset edhe nga donatori.

Mbyllet mbledhja e Këshillit në orën 12: 44

Sekretar
Etleva YZO

KRYETAR I KËSHILLIT

